

STATISTIKAT AFATSHKURTËRA TË TREGTISË ME PAKICË, TM4 2018

1. Kontakti

1.1. Organizata Kontaktuese:	Agjencia e Statistikave të Kosovës - ASK
1.2. Njësia kontaktuese në organizatë:	Departamenti i Statistikave Ekonomike - Sektori i Ndërmarrjeve
1.3. Emri i kontaktit:	Hysni Elshani
1.4. Funkzioni i personit kontaktues:	Zyrtar i lartë për Statistika të Ndërmarrjeve
1.5. Adresa e plotë kontaktuese:	Rruga "Zenel Salihu" no 4. 10000 Prishtinë, Kosovë
1.6. Adresa e emailit kontaktues:	hysni.elshani@rks-gov.net
1.7. Numri kontaktues:	+ 381 38 200 31 133
1.8. Numri kontaktues i faksit:	Nuk ka numër të faksit në dispozicion. Numri i faksit është i përgjithshëm: +381 38 235 033

2. Prezantimi i statistikave

2.1. Përshkrimi i të dhënave:	Qëllimi i anketës tremujore të tregtisë me pakicë është që të sigurojë të dhëna për qarkullimin e mallrave. Anketa mbledh të dhëna mbi tregun e shitjes së mallrave me TVSH, TVSH-në e llogaritur, numrin e të punësuarve dhe numrin e orëve të punës për muajin e raportimit. Të dhënat e tregtisë me pakicë mund të përdoren për hulumtimin e trendëve aktuale dhe kushtet në tregun e mallrave të konsumit, nga pikëpamja e ndryshimeve në qarkullimin e mallrave, si dhe ndryshimeve sezonale në vëllimin e shitjeve dhe të tregtisë nga grupe të mallrave.
2.2. Sistemi i klasifikimit:	Tregtia me pakicë bënë grumbullimin e të dhënave sipas klasifikimit të aktiviteteve ekonomike NACE Rev.2, grupi 46, 47.
2.3. Mbulimi nga sektori:	Statistikat e tregtisë mbulojnë sektorin ekonomik G.
2.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet:	Ndërmarrja - është njësia më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike. Ndërmarrje aktive - konsiderohen vetëm ato ndërmarrje që kanë deklaruar njërin nga tatimet apo ndonjë të punësuar për vitin referues. Vlera e qarkullimit nga tregtia - paraqet qarkullimin e realizuar nga tregtia duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar. Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Indeksi i vlerës së qarkullimit nga tregtia me pakicë - paraqet ndryshimin në një tremujor të qarkullimit nga tregtia me pakicë krahasuar me mesataren tremujore të vitit bazë (2013). Numri i të punësuarve - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë që punojnë në ndërmarrje (përjashtuar pjesëtarët e familjes që punojnë pa pagesë). Indeksi i Numrit të punësuarve - Indeksi i punësimit paraqet ecurinë e punësimit në ndërmarrjet e anketuara.
2.5. Njësia statistikore:	Njësi të hulumtimit janë ndërmarrjet aktive gjatë vitit të fundit kalendarik.

2.6. Popullsia statistikore:	Korniza për mostër është nxjerrë nga Regjistri statistikor i Bizneseve. Janë të përfshira vetëm bizneset në kuadër të grupit 46,47 - tregtia me pakicë dhe vetëm ato që janë aktive gjatë vitit të fundit referues.
2.7. Zona referuese	Kosova (niveli kombëtar).
2.8. Mbulimi kohor:	Seritë kohore janë në dispozicion nga viti referues 2013. Periudha referuese është tremujore (p.sh.1 tetor - 31 dhjetor 2018).
2.9. Periudha bazë:	Nuk aplikohet.

3. Përpunimi statistikor

3.1. Burimi i të dhënave:	Burim i të dhënave janë të gjitha bizneset e përzgjedhura për mostër e të cilat i përkasin grupit dyshifror 47 sipas NACE – Rev.2. Korniza e mostrës bazohet në të dhënat nga Regjistri statistikor i bizneseve.
3.2. Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave:	Mbledhja e të dhënave është tremujore.
3.3. Mbledhja e të dhënave:	Mbledhja e të dhënave bëhet për mes intervistimit të drejtpërdrejtë të bizneseve të përzgjedhura.
3.4. Vlefshmëria e të dhënave:	Pas përfundimit nga intervistuesit vazhdohet me kontrollin logjik në zyrë para se të bëhet futja e të dhënave. Kontrollimi i të dhënave pas futjes së të dhënave, krahasimi i të dhënave në nivel të agreguar me periudhat paraprake.
3.5. Hartimi i të dhënave:	Nuk është në dispozicion.
3.6. Përshtatja/rregullimi:	Nuk është në dispozicion.

4. Menaxhimi i cilësisë

4.1. Sigurimi i cilësisë:	ASK është e angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në "LIGJIN Nr. 04/L-036 PËR STATISTIKAT ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS", ASK përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të saj, ASK ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). ASK ka zhvilluar një Deklaratë të Cilësisë e cila gjendet në faqen e internetit të ASK-së: http://ask.rks-gov.net/media/1889/deklarata-e-cilesise.pdf . Dokumenti përmban njëmbëdhjetë parime, në përputhje me parimet e CoP, si pavarësia profesionale dhe konfidencialiteti statistikor, në të cilat bazohet puna e ASK-së.
4.2. Vlerësimi i cilësisë	Gjatë vitit 2017 Në Agjencinë e Statistikave të Kosovës është kryer procesi i vlerësimit të Sistemit Statistikor të Kosovës përmes qasjes "Peer Review".

5. Relevanca

5.1. Nevojat e përdoruesve:	Qëllimi kryesor i tregtisë me pakicë është paraqitja e trendeve tremujore në sektorin e shitjes me pakicë nëpërmjet disa treguesve ekonomik, e cila lejon krahasueshmërinë e të dhënave në nivel ndërkombëtar bazuar
-----------------------------	--

	standardet evropinane për statistikat tremujore. Përdoruesit kryesore janë Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, institucionet e ndryshme kërkimore, statistikat e llogarive kombëtare dhe sektorë të tjerë brenda ASK-së.
5.2. Kënaqshmëria e përdoruesve:	Njëra ndër elementet kyçe për të siguruar cilësinë e të dhënave statistikore është matja e kënaqshmërisë së përdoruesve. Anketa ka për qëllim që të grumbulloj informacion të plotë mbi nevojat dhe kërkesat e përdoruesve dhe shfrytëzuesve të të dhënave zyrtare statistikore. Me anë të kësaj ankete shfrytëzuesit e të dhënave statistikore kanë shprehur mendimet dhe opinionet e tyre lidhur me pikëpamjet statistikore, kanë dhënë këshilla dhe sugjerime lidhur me nevojat e tyre për statistika si dhe për përmirësimin e këtyre të dhënave statistikore në të ardhmen. Këtë vit u zhvillua për herë të dytë Anketa e kënaqshmërisë së përdoruesve. Qëllimi i këtij ankete është të matë nivelin e kënaqshmërisë së përdoruesve të të dhënave dhe të kemi informacion të plotë mbi nevojat dhe kërkesat e përdoruesve. Pyetësi u plotësua nga 34 përdorues, të përbërë nga 14 pyetje. Rezultatet e këtij studimi do të jenë në dispozicion në faqen e internetit të ASK-së.
5.3. Plotësia:	Nuk është në dispozicion.
5.4. Plotësia - norma, shkalla:	Nuk është në dispozicion.
6. Saktësia dhe besueshmëria	
6.1. Saktësia e përgjithshme:	Në përgjithësi, të dhënat kontrollohen dhe krahasohen me periudhën paraprake ose me periudhat e njejta vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në të dhënat. Këto pyetje janë konfirmuar me pasqyrat financiare ose me një burim administrativ kur është e mundur.
6.2. Gabimi në mostra:	Gabimet e marrjes së mostrave trajtohen në raportet e brendshme teknike, kur për çdo indikator në vrojtim në llogarisim variancën e përgjithshme, e cila vlerësohet si shuma e variancës së të gjitha shtresave të përgjithshme dhe gabimet standarde relative, për të eliminuar efektin negativ të aktivitetit të NACE ndryshuar në të dhënat e serive të STS. Të gjitha vlerat treguese janë të peshuara për të përfaqësuar popullatën.
6.2.1. Gabimi në mostra - treguesit:	Nuk është kalkuluar devijimi standard për ndonjë indikator.
6.3. Gabim jo - i mostrave:	Gabimet e mos marrjes së mostrave janë gabimi që kanë ndodhur gjatë fazave të tjera të anketës: Gabimi i mbulimit janë gabimet që lidhen me kornizën; divergjencat midis kornizës dhe popullatës së synuar. Gabimet që ndodhin gjatë grumbullimit të të dhënave, gabimet e përpunimit dhe gabimi i mos përgjigjes kur anketa nuk arrin të marrë përgjigje ndaj një ose ndoshta të gjitha pyetjeve.
6.3.1. Mbulimi i gabimit:	Gabimet e mbulimit përfshijnë si mbi-mbulimin ashtu edhe nën-mbulimin. Përditësimi i fundit nga Regjistri statistikor i bizneseve nuk janë të përfaqësuar mirë dhe gabimet lindin për shkak të dallimeve ndërmjet kornizës dhe popullsisë së synuar. Gabimi i nën-mbulimit është që njësitë e popullsisë së synuar nuk janë të qasshme nëpërmjet kornizës dhe ato gabime janë të vështira për t'u matur. Gabimi i mbi-mbulimit është gabimi

	për shkak të qasshmërisë së njësisë nëpërmjet kornizës që nuk i përkasin popullsisë së synuar. Fokusi kryesor ishte gabimi i mbi-mbulimit.
6.3.1.1. Mbi - mbulimi - norma, shkalla:	Nuk është e zbatueshme.
6.3.1.2. Njësitë e përbashkëta - proporcioni:	Nuk është e zbatueshme.
6.3.2. Gabimi në matje:	Të dhënat grumbullohen përmes intervistimit të drejtpërdrejtë nga ana e Anketuesev të angazhuar me Kontrate, përmes Pyetesorit d.m.th. aplikohet metoda PAPI; Trajnimi adekuat i intervistuesve - për të shmangur refuzimin dhe gabimet; Kontrollimi në terren lidhur me cilësinë. Ri-kontaktimi i bizneseve pas intervistimit. Gabimet me të shpeshta janë tek: -mungesa e të dhënave adresore; - gabimet tek vlerat pas presjes decimale, etj.
6.3.3. Gabimi në mos - përgjigje:	Njësi e mospërgjigjes merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje ose nuk dëshirojnë të japin përgjigjet ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje të gjejnë adresën e ndërmarrjeve ose kur ekzistojnë barrierat tjera për të përfunduar intervistën.
6.3.3.1. Njësia jo - përgjigje - norma P:	Shkalla e mos përgjigjes është 32,91%.
6.3.3.2. Artikulli jo - përgjigje - norma P:	Not available.
6.3.4. Gabimi në përpunim:	Gabimet gjatë përpunimit të të dhënave janë për shkak të gabimeve teknike.
6.3.4.1. Norma e Imputimit:	Nuk është në dispozicion.
6.3.5. Gabimi në supozim të modelit:	Nuk është në dispozicion.
6.4. Rregullimi sezonal:	Nuk është në dispozicion.
6.5. Rishikimi i të dhënave - politika:	Në ASK nuk ka politika të rishikimit
6.6. Rishikimi i të dhënave - praktika:	Nuk është kryer asnjë rishikim.
6.6.1. Rishikimi i të dhënave - madhësia mesatare:	Nuk është në dispozicion.

7. Afati kohor dhe përpikëria

7.1. Afati kohor:	Të dhënat publikohen në baza tremujore që nga viti 2013. Periudha referuese për TM4 2018 është 1 tetor- 31 dhjetor 2018.
7.1.1. Vonesa në kohë - rezultatet e para:	Nuk është në dispozicion.
7.1.2. Vonesa në kohë - rezultatet përfundimtare për P:	Rezultatet përfundimtare janë publikuar më 20 mars 2019.
7.2. Përpikëria:	Te dhënat e Statistika Afatshkurtëra të Tregtisë me Pakicë janë publikuar në kohë.
7.2.1. Përpikëria - ofrimi dhe përpunimi për P:	Vonesa në kohë është 0.

8. Koherenca dhe krahasueshmëria

8.1. Krahasueshmëria - gjeografike:	Statistikat janë të krahasueshme mes zonave gjeografike.
8.1.1. Asimetria për pasqyrën e rrjedhës së statistikave - koeficienti:	Nuk është në dispozicion.
8.2. Krahasueshmëria nëpër kohë:	Nuk ka ndërprerje të serive kohore.

8.2.1. Gjatësia e serive kohore të krahasueshme për P:	Krahasueshmëria është nga 2013-2018. CC2 = 6.
8.3. Koherenca - fushat e ndërlidhura:	Nuk është në dispozicion.
8.4. Koherenca - statistikat gjysmë-vjetore dhe vjetore:	Nuk është në dispozicion.
8.5. Koherenca - Llogaritë Kombëtare:	Nuk është në dispozicion.
8.6. Koherenca - e brendshme:	Të dhënat kontrollohen para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri e tyre. Të dhënat janë koherente në aspektin e brendshëm.

9. Qasja dhe qartësia

9.1. Njoftimet për shtyp:	Njoftimet për shtyp janë on-line në kohën e shpërndarjes së të dhënave. Përshkrimi shkurtër në dokumentacionin e metodologjisë përfshin qarkullimin në sektorin e tregtisë me pakicë, numri I të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë, Indeksi i qarkullimit dhe numrit të të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë etj.
9.2. Publikimet:	Publikimet e ASK-së, tabelat dhe materialet për njoftim për shtyp, janë gjithmonë në dispozicion në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe serbisht
9.3. Baza e të dhënave online:	ASK ka bazën e të dhënave online: http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/?rxid=48d7fed2-90d9-4873-8854-c1e793ecafad
9.3.1. Tabelat e të dhënave - konsultimet:	Nuk është në dispozicion.
9.4. Qasja në mikro - të dhënat:	Përdoruesit nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë në mikro-të dhënat, por me ligj studiuesit/hulumtuesit dhe institucionet mund të kërkojnë qasje përmes ASK-së.
9.5. Tjetër:	Nuk është në dispozicion.
9.6. Dokumentacioni mbi metodologjinë:	Metodologjia për Statistikat Afatshkurtëra të tregtisë me pakicë është përshkruar në publikim në pjesën e metodologjisë: http://ask.rks-gov.net/media/4628/statistikat-afatshkurtra-t%C3%AB-tregtis%C3%AB-me-pakic%C3%AB-tm4-2018.pdf .
9.7. Dokumentacioni për cilësi:	Asnjë vlerësim për cilësinë nuk është në dispozicion.
9.7.1. Shkalla e plotësisë - metadata:	Nuk është në dispozicion.
9.7.2. Metadata - konsultime:	Nuk është në dispozicion.

10. Kostoja dhe barra

Kostoja e STS përfshin informacionin për numrin e përhershëm dhe të përkohshëm të stafit. Shpenzimet për trajtimin e mospërgjigjes janë pa kosto, sepse ASK përdor burime administrative për imputimin. Marrëveshja e bashkëpunimit e nënshkruar ndërmjet ASK, ARBK dhe AT, mundëson që transmetimi i burimeve administrative të jetë pa kosto. Burimet statistikore si (BR, STS etj) janë gjithashtu pa kosto, sepse ato konsiderohen si përdorues të brendshëm. Stafi i STS menaxhon kontrollin dhe analizën e të dhënave, kështu që këto dy procese nuk kanë kosto shtesë.

11. Konfidencialiteti

11.1. Konfidencialiteti - politika:	"Agjencia do të sigurojë që të dhënat individuale të mbledhura për qëllime statistikore, të mbledhura nga persona fizikë ose juridikë, apo
-------------------------------------	--

	<p>organet dhe organizatat e administratës publike (më tej "Respodentët"), të trajtohen në mënyrë rreptësishtë konfidenciale dhe të përdoren vetëm për qëllime statistikore. Ligji 04/L-036, Neni 34.</p> <p>"Të gjithë të anketuarit (respodentët) janë të detyruar, në pajtim me ligjin në fuqi, të bashkëpunojnë dhe të ofrojnë të dhëna në kohë dhe me saktësi statistikore në Agjenci, dhe të bashkëpunojnë me Agjencinë për të verifikuar saktësinë e të dhënave të mbledhura. LIGJI Nr. 04/L-036 PËR STATISTIKAT ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Neni 21: http://ask.rks-gov.net/media/2023/ligji-per-statistikat-zyrtare-te-republikes-se-kosoves.pdf</p>
<p>11.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave:</p>	<p>Qasja në të dhënat konfidenciale do t'u lejohet vetëm personave të cilët janë përgjegjës për prodhimin e statistikave zyrtare deri në atë nivel që këto të dhëna janë të nevojshme për prodhimin e statistikave. Neni 37, Ligji Nr 04/L-036: http://ask.rks-gov.net/media/2023/ligji-per-statistikat-zyrtare-te-republikes-se-kosoves.pdf</p>
<p>12. Komete</p>	
<p></p>	